



REPUBLIKA E KOSOVËS /REPUBLICA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Kryetari i Komunës

01nr 40005-8041

Dt: 26.03.2018

Kryetari i Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 11,13 dhe 58. a dhe b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 9, 10 dhe 33 të Rregullores për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Komunale, me qëllim që të lehtësojë punën e OJQ “Jakova Innovation Center, për krijimin e kushteve më të mira për bizneset e reja dhe ndërmarrësit e rinj, me dt: 26.03.2018 e miraton këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e OJQ J “Jakova Innovation Center” nr. 01-400/04-1773 e dt. 05.02.2018, për realizimin e projekteve të vazhdueshme me qëllim të përkrahjes së bizneseve të reja në Komunën e Gjakovës dhe krijimin e një ambienti më të favorshëm të të bërit biznes,për bizneset e reja dhe ndërmarrësit e rinj, duke e mbështetur këtë kërkesë me subvencione komunale në vlerë prej 3,000.00€.

2. Autorizohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që në harmoni me të gjitha dispozitat ligjore në fuqi, të realizon zotimin e mjeteve financiarë në vlerë prej 3,000.00€, nga pozicioni i subvencioneve të Zyrës së Kryetarit të Komunës dhe bartjen e këtyre mjeteve në xhirollogarinë OJQ “Jakova Innovation Center” nr. 1505030000509708 Raiffeisen Bank.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Vendimi i'u dërgohet:

- Kabinetit të Kryetarit të Komunës
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik
- OJQ “Jakova Innovation Center” Gjakovë
- Arkivit



Kryetari i Komunës

Ardian Gjini